



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
14 Nr. 645/23  
Dt. 18.07.2023

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ Gurëbardhi “sh.p.k. & “ Diari Company “sh.p.k. me seli në Klinë, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. 12.07.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën 18.07.2023 bie këtë:

**V E N D I M**

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : “ Gurëbardhi “sh.p.k. & “ Diari Company “sh.p.k. me seli në Klinë, e datës 17.07.2023, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 12.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ Asfaltimi i rrugës Sllakoc – Kurillovë – Vesekovc “, me Nr. Prok: VU644 – 23 – 4155 – 5-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 042 – 521
2. **Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i dt. 12.07.2023**
3. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së do të vazhdoi me ri vlerësim të aktivitetit të prokurimit.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : “ Asfaltimi i rrugës Sllakoc – Kurillovë – Vesekovc “, me Nr. Prok: VU644 – 23 – 4155 – 5-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 042 – 521 , të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik : “ Haxha Kom “sh.p.k. me seli në fsh. Gojbulë / K. Vushtrri. Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. “ Gurëbardhi “sh.p.k. & “ Diari Company “sh.p.k. me seli në Klinë ( në tekstin e mëtejme Ankuesi ) e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni 1 – Qëllimi, neni – 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni – 9 – Përcaktimi i nevojave që duhen të prokurohen, 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, neni 69 – Aftësia Teknike dhe Profesionale dhe neni 72 – Dokumentet dhe informacionet shtesë.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimi të provave në shkresat e lëndës dhe të Dosjes së Tenderit të Ankuesit, u konstatua se Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit është pjesërisht e bazuar. Në dosjen e tenderit të Ankuesit rezultoi se është dorëzuar, bashkëgjatur me Dosjen e Tenderit, dokumenti : Aneksi 7 - Lista mbi mekanizimin dhe pajisjet teknike në dispozicion. e nënshkruar dhe e vulosur, ashtu sikurse është saktësuar , respektivisht kërkuar në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD – nenin 9.1 lidhur me 9.2 pika 4. Rrjedhimisht, ekzistenca në Dosjen e Tenderit, e dokumentit të kërkuar, tenderin e Ankuesit e bënë të përgjegjshëm sa i takon dokumentit në

fjalë, dhe në procesin e ri-vlerësimit tenderi i Ankuesit do të vlerësohet, ekzaminohet në pajtim me dispozitat e nenit 59 të LPP-së .

Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të bazuara në dispozitat e LPP-së., me theks të veçantë neni 1 - Qëllimi, nenin 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti, neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo diskriminimi si dhe neni 59 parag.4 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të bazuara, dhe si të tilla janë aprovuar.

**Këshillë juridike:**


**Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë  
K.R.. nr. 042/2023, datë 18.07.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

**Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik**



Albanez Tahiraj